



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI"  
Prizren



Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref.01- 70 Prizren, me 16.03.2018

**Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 16 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe vendimin e Këshillit Drejtues të datës 12.12.2017, Universiteti „Ukshin Hoti“ në Prizren, shpall:**

### KONKURS

PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENTËT E UPZ-SË

Ftohen studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren që të aplikojnë për punë praktike në administratën e Universitetit.

Puna praktike ka si objektiv që t’ju ofrojë studentëve mundësi që dijen teorike të nxënë gjatë studimeve, ta aplikojnë në praktikë, dhe njëkohësisht të fitojnë përvojë të punës praktike.

Kjo praktikë do t’ju ndihmojë studentëve që t’i zbulojnë fushat e tyre të interesit, si dhe ta kenë më të qartë se në cilën punë specifike dëshirojnë që të punësohen në të ardhmen.

Praktikantët do të stimulohen me një shumë simbolike prej 50 euro në muaj në emër të shujtës ditore.

**Numri i pozitave: 10 praktikantë.**

**Kohëzgjatja e punës praktike : 3 muaj**

#### Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

- Kandidatët për punë praktike duhet të jenë: apsolvent në nivelin e studimeve baçelor ose student aktiv të nivelit master të studimeve në Universitetin “Ukshin Hoti”.
- Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike, Komisioni do të marrë parasysh notën mesatare të studentëve.
- Praktikanti/ja preferohet të ketë: Shkathtësi të komunikimit; aftësi të mira analitike, Shkathtësi dhe njohuri në aplikimin e programeve kompjuterike nga pako Microsoft Office dhe shkathtësi në punë teknike; Aftësi të punës në grupe.

#### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe mënyra e aplikimit

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

1. CV
2. Kërkesën për shprehje interesi,
3. Certifikatën e notave,
4. Vërtetimin mbi statusin e studentit-master ose kopjen e diplomës baçelor,
5. Kopjen e letërnjoftimit.

## **Konkursi mbetet i hapur 15 ditë.**

- Data për aplikim është nga 16.03.2018 deri më 30.03.2018 në ora 15:00.
- Shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni ad hoc do të bëhet me datën 02.04.2018 në faqen zyrtare të Universitetit.
- Studentët e përzgjedhur për punë praktike, do të nënshkruajnë kontratën e angazhimit me Universitetin e Prizrenit.
- Dokumentet duhen të dorëzohen në formatin elektronik pdf në e-mail adresën: [apliko.upz@uni-prizren.com](mailto:apliko.upz@uni-prizren.com)
- Studentët do të jenë të angazhuar me orar të plotë sipas rregullores 05/2010.
- Praktika për studentët e përzgjedhur do të zgjasë tre muaj (3 muaj), nga data 02.04.2018 deri më 29.06.2018

Kandidatët që nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që funksionon në kuadër të administratës së Universitetit.

**Inkurajohen që të aplikojnë të gjithë studentët e UPZ-së pa kurrfarë dallimi, respektivisht të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.**

**Praktikantët në përfundim të programit të punës praktike do të pajisen nga Universiteti “Ukshin Hoti” me: Referencë dhe Certifikatë.**

